Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1053

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Krytera, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Ejona" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Shërbimi Korrektues i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubravë" me numër të prokurimit 33600-23-5845-5-2-1, me 09/02/2024, mori:

Vendim

1. **Anulohet,** në tërësi aktiviteti i prokurimit "Instalimi i paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubravë" me numër të prokurimit 33600-23-5845-5-2-1, inicuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK).

2. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Eor Group SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 08.06.2023 Shërbimi Korrektues i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi i paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubravë” me numër të prokurimit 33600-23-5845-5-2-1.

Me 08.12.2023 Ejona SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 15.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Ejona” SH.P.K me nr. 1053/23 lidhur me aktivitetin e sipërcituar.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues OE "Ejona" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se: "Pasi qe OSHP mori vendim qe te cilësojë ankesën tone si te bazuar, pra qe AK nuk ka pasur te drejte te na eliminoje nga gara sepse ishim te përgjegjshëm. Si duket AK-se nuk i pelqeu vendimi i OSHP-se dhe vendosi qe te anuloje tere aktivitetin me pretendimin se tani me nuk kane buxhet për këtë aktivitet. Për te mbështetur këtë pretendim AK bashkëngjit një letër e cila daton nga viti 2021, ku shënon se buxheti për këtë projekt është i parapare ne vitin 2023. Është tërësisht normale qe ne vitin 2021 te mos parashihet se AK do te vonoje procedurën me vendime te jashtëligjshme, andaj ajo letër nuk mbështet asgjë. Sipas LPP dhe Rregullores se Prokurimit publik, përkatësisht Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, ekzistojnë vetëm disa kushte qe një aktivitet te anulohet, dhe ato kushte nuk janë plotësuar asnjëra për këtë aktivitet. Për këtë çështje ne kemi kërkuar edhe interpretim nga KRPP, ku KRPP na përgjigjet se ne LPP është shume e qarte se cilat kushte duhet te plotësohen për anulimin e një aktiviteti publik, dhe mungesa e buxhetit nuk është asnjëra prej atyre kushteve. Bashkangjitur gjeni edhe interpretimin e KRPP lidhur me këtë çështje."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka autorizuar eksperten shqyrtues e cila me datë 18.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1053 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi i AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim*".

Lidhur me pretendimet e "Ejona" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1053 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së edhe më herët në lidhje me eliminimin nga aktiviteti i prokurimit, ku eksperti shqyrtues paraprak dhe paneli shqyrtues përmes Vendimit me numër 2023/0681 kanë aprovuar ankesën e OE ankues si të bazuar dhe e kanë kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim. Pas rivlerësimit AK merr vendim për anulim të këtij aktiviteti me arsyetimin se AK nuk ka ndarje buxhetore për vitin 2024 dhe 2025 për këtë aktivitet prokurimi, andaj për arsye buxhetore bënë anulim të aktivitetit edhe pse pas rivlerësimit AK, OE-në ankues, nga operator i eliminuar e shpallë si operator të pasuksesshëm.

Duke u bazuar në nenin 62 të LPP-së- Përfundimi i aktivitetit të prokurimit, ky nen tregon arsyet se kur një Autoritet Kontraktues duhet të përfundoj një aktivitet prokurimi. OE ankues i është drejtuar edhe KRPP-së për interpretim të anulimit, ku të njëjtit kanë kthyer përgjigje se për t'u anuluar një aktivitet prokurimi duhet që arsyet të jenë në përputhje me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së, ku caktohen kushtet në të cilat një aktivitet mund të përfundoj. Asnjë nga arsyet e këtyre neneve, nuk parashohin arsyetimin e anulimit i cili lidhet me mjetet buxhetore.

Përmes sistemit e-prokurimi, tek Deklarata e nevojave, AK ka deklaruar shumën e paraparë të ndarë për këtë aktivitet prokurimi dhe arsyetimi se pas 6 muajsh ky prokurim duhet të anulohet për shkak se AK nuk ka mjete buxhetore për vitin pasues, sipas ekspertit nuk është aspak në rregull dhe serioz.

Mendimi i ekspertit është se ndarja e mjeteve të caktuara për një aktivitet i cili nuk është realizuar në vitin paraprak, mund të bëjë bartjen e mjeteve për të njëjtin aktivitet në vitin pasues siç e parasheh edhe Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës s? Kosovës p?r vitin 2023 (LIGJI NR. 08/L-193). Mjetet të cilat janë ndarë tashmë, është dashur të barten në vitin pasues, pasi që është e parashikuar që jo gjithmonë fazat e vlerësimit të aktivitetit të prokurimit mund të përfundohen brenda kohës së parashikuar. Andaj, eksperti sqaron edhe njëherë se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 62 të LPP-së dhe nga kjo çfarë kemi sqaruar më lartë vlerësojmë që ky pretendim është i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklarohet rreth se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtuese.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se aktiviteti i prokurimit "Instalimi i paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubravë" me numër të prokurimit 33600-23-5845-5-2-1 është trajtuar me vendimin paraprak të OSHP Nr. 2023/0681 i publikuar me datën: 03/11/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektoj dispozitat ligjore nenin 59, 60 të LPP. Por paneli shqyrtues tani sipas arsyetimit të AK ka ndryshuar gjendja dhe është dashtur detyrimisht të anulohet procedura e prokurimit për shkak të mungesës së mjeteve.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ky aktivitet i prokurimit është anuluar me arsyetimin se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit "Në kodin buxhetor 19095 për vitin 2024 dhe 2025 nuk kemi ndarje buxhetore, vlera është 0.00 euro, kurse gjatë këtij viti nuk ka mundësi të realizohet". Lidhur me këtë OSHP me qëllim të vërtetimit të saktë të gjendjes reale, më dt. 08.02.2024, ju drejtohet zyrës së prokurimit me këtë email "Je*mi në shqyrtim të ankesës me nr. të protokolit 2023/1053, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubrave" me nr. të prokurimit: " 33600-23-5845-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Shërbimi Korrektues I Kosovës, për të cilin aktivitet ju e keni publikuar vendimin me dt. 04.12.2022, cituar "Në kodin buxhetor 19095 për vitin 2024 dhe 2025 nuk kemi ndarje buxhetore, vlera është 0.00 euro, kurse gjatë këtij viti nuk ka mundësi të realizohet" Pretendimet ankimore janë se nuk janë përmbushur kushtet e nenit 62 të LPP-së, sa I përket anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj, ju lutem të na ofroni dëshmi se nuk keni mjete financiare për këtë aktivitet apo që nuk është në planin buxhetor të këtij institucioni*".

Zyra e prokurimit në AK Shërbimi Korrektues i Kosovës, kthen emailin me dt. 08.02.2024, duke e bashkangjitur buxhetin per vitin 2023 dhe buxhetin per vitin 2024 se nuk ka mjete për këtë

aktivitet të prokurimt dhe me këtë arsyetim "*Anulimi i këtij aktiviteti te prokurimit është bërë për arsye se nuk kemi mjete financiare për vitin 2024 dhe 2025. Zyra e prokurimit është njoftuar me shkrim nga ZKF-ja, ZKA-ja, si dhe zyra e Inxhinjeringut si njësi kërkuese se nuk kemi ndarje buxhetore për mbulimin e këtij projekti i cili kalon për realizim ne vitin 2024.Si dëshmi te këtij vendimi i bashkëngjitet planifikimi buxhetor i vitit 2024. Me qenë se nuk kemi mundësi te sigurohen mjetet buxhetore për ketë projekt Disponueshmeria e mjeteve nuk është nënshkruar nga ZKA – Ja dhe ZKF-ja. RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 8 .5 nder te tjera thotë: Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar.*

Tek Disponueshmeria e mjeteve Neni 3: Shqyrtimi, nder te tjera shënon: Kjo "Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve" duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim te kontratave para publikimit te Njoftimit për dhënie te kontratës me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht. Në ketë rast pas shqyrtimit nga personat e autorizuar para publikimit te njoftimit për dhënie te kontratës, zyra e prokurimit ka pranuar shkresën ku saktëson se ka ndryshim te mjeteve buxhetore se ky projekt nuk mund te realizohet për arsyet e cekura më lartë. Nëse i referohemi LPP-së Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dispozitë e këtij ligji është edhe neni 8.5 i Rregullores se Prokurimit Publik gjithashtu edhe Rregullat financiare me nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike.

Bazuar në RREGULLEN FINANCIARE NR.01/2013/MF – SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE Neni 13 Menaxhimi i projekteve kapitale "Projektet kapitale menaxhohen me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ligji për ndarjet buxhetore përmban vlerësimet se sa do të shpenzohen në secilin projekt dhe në secilin vit. SIMFK përmban kufizime ashtu që fondet e alokuara në kategorinë ekonomike të "kapitalit" mund të zotohen vetëm për projekte të tilla. Nëse një projekt kapital duhet të realizohet në vitin e tanishëm, dhe është vonuar, atëherë fondet mund të zotohen në një vit në të ardhmen për ta përfunduar projektin kapital vetëm nëse kjo pasqyrohet në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, nga ndarjet buxhetore të vitit të ardhshëm të BRK". Ne buxhetin e vitit 2024 nuk ka mjete buxhetore shihet qarte se nuk ka mjete. Te bashkangjitur gjeni tabelën 3.2 Projektet Kapitale për Nivelin Qendror ku ne tabelë shihet se kodi për ketë projekt nuk ekziston fare".

Andaj, si pasojë e gjendjes së krijuar, përgjegjësin e mban vetë autoriteti kontraktues edhe sa i përket përmbajtjes së të gjitha shkresave, ndërsa, PSh detyrimisht duhet ta lë në fuqi anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik si dhe rregulloret financiare të cituara nga AK. Si rrjedhoj, AK nuk mund të vihet në një gjendje ku do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i pasur mjetet në dispozicion.

Sipas nenit 8.3 të RRUOPP, citat: "Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo

dispozitë do të përfshihet në kontratën publike.”

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, dhe të prolongimi deri në pafundësi të aktivitetit të prokurimit, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**
- OE - **" EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: